

KËSHILLI STATISTIKOR

RAPORTI VJETOR 2012

Prishtinë, 2013

P Ë R M B A J T J A

| | |
|--|---|
| 1. Hyrje | 3 |
| 2. Baza ligjore | 4 |
| 3. Aktivitetet kryesore gjatë vitit 2012 | 6 |
| 4. Plani i punës i Këshillit Statistikor për vitin 2013..... | 7 |

1. Hyrje

Sistemi Statistikor i Kosovës jo vetëm që ka qenë larg të të qenit Sistem i mirëfilltë statistikor, por për të qenë i tillë i ka munguar edhe baza ligjore adekuate. Përgjegjësia e prodhimeve statistikore ka qenë e rregulluar përmes rregulloreve të UNMIK-ut për ish-Entin e Statistikave të Kosovës dhe përmes rregulloreve të tjera kjo përgjegjësi ka qenë e shpërndarë edhe tek institucionet e tjera të Kosovës.

Aprovimi i Ligjit për Statistika Zyrtare nga ana e Kuvendit të Kosovës në fund të vitit 2011, ka krijuar bazën ligjore për krijimin, konsolidimin dhe fuqizimin e Sistemit Statistikor në Republikën e Kosovës.

Bazuar në nevojat dhe kërkesat bashkëkohore, bazuar në rekomandimet e institucioneve relevante ndërkombëtare dhe vendore, në Ligjin e Statistikave Zyrtare Nr. 04/L-036 është vendosur obligimi i krijimit të Këshillit Statistikor.

Një organ të tillë e kanë shumë vende të BE-së që kanë institucione të zhvilluara statistikore, prandaj edhe Republika e Kosovës e kishte të domosdoshme ta krijoj dhe atë jo vetëm sa për të qenë një përmbushje formale e këtij obligimi, por për të marr kërkesat e shfrytëzuesve statistikor dhe për ti shndërruar ato në këshilla dhe rekomandime të rëndësishme në avancimin e Sistemit Statistikor të Kosovës në tërësi. Në këtë mënyrë Këshilli Statistikor do të luaj edhe një rol të rëndësishëm të koordinimit në mes të prodhuesve statistikor, shfrytëzuesve statistikor dhe hulumtuesve statistikor, me qëllim të ngritjes së sasisë, cilësisë dhe frekuencës së prodhimeve statistikore.

Dhënia e rekomandimeve në fushën e statistikave, qofshin ato në kuadër të prodhimeve të thjeshta statistikore, qofshin ato plane afatshkurta dhe programe strategjike statistikore, është një kontribut i jashtëzakonshëm i Këshillit Statistikor. Prandaj Ligji i Statistikave Zyrtare ka përcaktuar edhe përfaqësimet e institucioneve qeveritare, joqeveritare, bizneseve, hulumtuesve shkencor statistikor, në mënyrë që ky organ të ketë përfaqësim meritator duke përfshirë të gjitha fushat me rendësi në procesin e përgjithshëm statistikor.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-036, Këshilli Statistikor është themeluar me Vendim të Kryeministrit të Kosovës dhe gjithashtu ky Këshill në baza vjetore i raporton Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë së Kosovës. Prandaj Këshilli Statistikor në bazë të këtij obligimi ka përgatitur këtë raport vjetor.

2. Baza ligjore

Këshilli Statistikor është themeluar me Vendim të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Nr. 097/2012, të datës 05.03.2012, në bazë të Ligjit për Statistikat Zyrtare, Nr. 04/L-036. Këshilli është organ kolegjal, i themeluar nga Ligji për të dhënë këshilla për përgatitjen dhe zbatimin e Programit të statistikave zyrtare dhe për zhvillimin e përgjithshëm të sistemit statistikor të Kosovës.

Këshilli Statistikor ka mandatin të kryej këto detyra:

- jep rekomandime për përgatitjen e Projekt programit të statistikave zyrtare, jep mendime dhe këshilla për ndryshimet, plotësimet e Programit dhe të Planit Vjetor;
- ofron mendime dhe këshilla për amendamentet, shtesat e Programit dhe të Planit Vjetor;
- krijon grupe punuese për zhvillimin e direktivave statistikore, për bashkimin e fushave statistikore në sistemin statistikor të Kosovës;
- thërret seanca në lidhje me progresin e arritur nga grupet punuese;
- monitoron, vlerëson dhe jep këshilla për zbatimin e Programit;
- jep mendime për ligjet dhe akte të tjera ligjore, që kanë të bëjnë me aktivitetet apo prodhuesit e statistikave zyrtare;
- jep mendime për zhvillimin e sistemit të statistikave zyrtare dhe bashkëpunimin ndërkombëtar;
- jep mendime për çështje të tjera me rëndësi për punën e statistikave zyrtare;
- komenton situatën buxhetore të zbatimit të Programit.

Këshilli përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë.

Anëtarë të Këshillit janë:

- Kryeshefi i Agjencisë së Statistikave të Kosovës;
- Përfaqësuesi i Ministrisë kompetente të Financave;
- Përfaqësuesi i Ministrisë kompetente të Tregtisë dhe të Industrisë;
- Përfaqësuesi i Ministrisë kompetente të Arsimit;
- Përfaqësuesi i Ministrisë kompetente të Shëndetësisë;
- Përfaqësuesi i Zyrës për Planifikim Strategjik;
- Përfaqësuesi i Bankës Qendrore të Kosovës;
- Përfaqësuesi i Administratës Tatimore;
- Përfaqësuesi i Ministrisë kompetente të Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Përfaqësuesi i Ministrisë kompetente të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Përfaqësuesi i Universiteti, ekspert i njohur për hulumtime në fushën e statistikave;
- Përfaqësuesi i shoqërisë civile, i cili përfaqëson organizatat e qendrave kërkimore, dhe

- Përfaqësues i Komunitetit të Biznesit.

Mandati i anëtarit të Këshillit është 5 vjeçar.

Pas themelimit të tij, në përbërje të të cilit janë 13 anëtarë, nga institucionet e ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, Këshilli Statistikor ka mbajtur disa takime të rregullta. Në bazë të Ligjit për Statistikat Zyrtare, në mbledhjen e parë, Këshilli ka zgjedhur edhe 2 anëtarë të tjerë, përfaqësues nga komuniteti i biznesit dhe organizatat kërkimore në fushën e statistikave dhe ka aprovuar Rregulloren e vet

Anëtarët, emërohen sipas Ligjit nga institucionet përkatëse. Kur vendi i një anëtari mbetet i lirë, Kryeshefi i dërgon menjëherë kërkesë institucionit, të cilit i përkiste anëtari i mëparshëm, për të emëruar anëtarin e ri.

Anëtarët e institucioneve qeveritare, caktohen nga radhët e nëpunësve civilë, nga njësitë përkatëse që merren me veprimtari statistikore apo fusha që ndërlidhen me fushëveprimin e Agjencisë.

Përfaqësuesi i Universitetit emërohet nga radhët e personelit akademik të Universitetit me një eksperiencë të gjatë në fushën e statistikave.

Pas emërimit të anëtarëve nga institucionet përkatëse, Kryeshefi i ASK-së përgatit listën e anëtarëve dhe ia dërgon Kryeministrit, i cili ka nxjerr vendim për themelimin e Këshillit.

Anëtarët përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe organizatave kërkimore-shkencore nga fusha e statistikave emërohen sipas procedurave të përcaktuara në Ligj dhe në Rregullore të Këshillit Statistikor.

Këshilli zakonisht mblidhet të paktën një herë në tre muaj, por mund të mblidhet edhe më shpesh, varësisht nga çështjet e kërkuara për shqyrtim nga Kryeshefi i ASK-së, Kryetari apo me kërkesën e së paku tre (3) anëtarëve të Këshillit.

Vendimet merren me votim të hapur dhe Kryetari i Këshillit voton i fundit. Këshilli vendos me shumicën e votave të anëtarëve prezent. Secili anëtar i Këshillit ka të drejtë vote në Këshill. Nëse votimi nuk ka qenë i fshehtë dhe votat janë të barabarta, vota e kryetarit të Këshillit është vendimtare.

ASK-ja mbështet teknikisht dhe përmes administratës veprimtarinë e Këshillit. ASK-ja e ushtron funksionin e Sekretarisë së Këshillit, ku mban procesverbalin e mbledhjes së Këshillit, bashkërendon punën e hartimit të rekomandimeve, raporteve dhe dokumenteve të tjera të nevojshme, kujdeset për mbajtjen, dërgimin dhe ruajtjen e dokumenteve që dalin nga puna e Këshillit, etj.

Këshilli i raporton Kryeministrit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës së paku një herë në vit, apo çdo herë tjetër kur kërkohet nga Kryeministri apo Qeveria.

3. Aktivitetet kryesore gjatë vitit 2012

Në përputhje me nenin 9 të Ligjit mbi Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës i cili definon përbërjen e Këshillit Statistikor, në shkurt 2012 është mbajtur takimi i parë i Këshillit Statistikor në përbërje të definuar sipas ligjit në fjalë (përfshijtur përfaqësuesit e biznesit dhe organizatave kërkimore).

Gjatë vitit 2012 Këshilli Statistikor ka mbajtur gjithsej 5 takime. Në përputhje me nenin 9 dhe nenin 10 mbi funksionimin e Këshillit Statistikor, gjatë takimit të parë që u mbajt me datë 24/02/2012 dhe në vazhdimësinë e këtij takimi më datë 06/04/2012 janë zgjedhur përfaqësuesit nga Biznesi dhe nga organizatat kërkimore në fushën e statistikave. Me shumicë votash në Këshill gjatë këtyre dy takimeve është vendosur që përfaqësues nga ana e bizneseve të jetë përfaqësuesi nga Aleanca Kosovare e Bizneseve ndërsa që nga organizatat kërkimore në fushën e statistikave të jetë përfaqësuesi nga Instituti IEME .

Pas zgjedhjes së përfaqësuesve nga ana e biznesit dhe organizatës kërkimore në fushën e statistikave, u finalizua përbërja e Këshillit Statistikor. Si rrjedhojë në takimin e dytë të organizuar më 11 maj 2012, me vota unanime Kryesues i Këshillit Statistikor u zgjodh z.Mentor Geci, Drejtor i Departamentit të Statistikës në BQK, ndërsa që Zëvendës kryesues u zgjodh z.Isa Krasniqi – Kryeshef i Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Në të njëjtën kohë u shqyrtua dhe aprovua përmbajtja e Rregullores së Këshillit Statistikor.

Këshilli Statistikor në mes të datave 15-16 nëntor 2012, ka marrë pjesë në Tryezën e organizuar nga ASK (të mbajtur në Tiranë) rreth hartimit të planit 5 vjeçar statistikor së bashku me Grupin Punues. Në kuadër të kësaj tryeze secili nga anëtarët e Këshillit Statistikor kanë dhënë kontributin e tyre këshillëdhënës në hartimin e planit në fushën e vet të përgjegjësisë. Roli i anëtarëve të Këshillit ka qenë i rëndësishëm në avancimin e mëtejshëm të kualitetit të këtij dokumenti strategjik planifikues duke u fokusuar në prioritizimin e fushave statistikore në kuadër të këtij dokumenti.

Për më shumë pas pranimin të draftit të parë të planit 5 vjeçar statistikor, gjatë takimit të katërt të Këshillit Statistikor më datë 10 dhjetor 2012 ku ishin prezent edhe këshilltarët nga organizata suedeze SIDA të cilët e mbështetnin hartimin e këtij dokumenti, u dhanë komente/sugjerime shtesë me qëllim të plotësimit ndryshimit dhe avancimit të kualitetit të draftit aktual para së draftit të dorëzohet për aprovim në Qeveri. Gjithashtu këto komente në formë të shkruar u përcollën edhe nga Kryesuesi i Këshillit Statistikor tek Kryeshefi i Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Në mes tjerash komentet e Këshillit u përqendruan në objektivat për vitet në vijim (përtej objektivave të parapara brenda Ligjit të Statistikave), përfshirja e planit të riskut si dhe kalendarit të publikimeve si dhe komente të përgjithshme rreth strukturës së dokumentit në përgjithësi.

Fokus i mëtejshëm i punës së Këshillit Statistikor, ka qenë konsolidimi dhe harmonizimi i bazës ligjore që rregullon fushën e publikimit të statistikave nga ana e prodhuesve zyrtarë të statistikave. Në këtë kontekst është kërkuar mbledhja e gjithë bazës ligjore përfshirë edhe

legjislacionin sekondar që rregullon publikimin e statistikave. Kjo për arsye të eliminimit të dallimeve në shifra të publikuara nga institucionet e ndryshme si dhe të identifikohen fushat ku mund të bëhet progres i mëtejshëm në kontekst të specifikimit më të përafërt të raportimit statistikor

Në kuadër të takimeve është diskutuar edhe për pozitën financiare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, dhe mundësinë e shqyrtimit të ngritjes së buxhetit për këtë institucion në funksion të ngritjes së kualitetit të statistikave të publikuara. Në kuadër të kësaj teme është shqyrtuar mundësia e përdorimit të rolit të Këshillit Statistikor si organ lobues në ngritjen e buxhetit për këtë institucion.

Në kuadër të Këshillit Statistikor është raportuar mbi aprovimin e Planit Statistikor 2013-2017 nga ana e Qeverisë së Kosovës më datë 09/01/2013, si dokument që ka mision kryesor të vetin përmbushjen e kërkesat e përdoruesve me të dhëna statistikore cilësore, të besueshme dhe objektive

Në takimin e fundit është diskutuar çështja e inicimit të funksionimit të grupeve punuese me qëllim të avancimit të publikimeve statistikore si dhe në funksion të përmbushjes së obligimeve statistikore ndërkombëtare si raportimi në GDDS (General Data Dissemination Standards) dhe të tjera. Gjithashtu në kuadër të këtyre diskutimeve është ngritur çështja e mos publikimit të statistikave tregtare nga ana e BQK, dhe adresimi i kësaj çështje, për faktin që është ngritur edhe si shqetësim nga ana e FMN-së. Për më shumë, publikimi i statistikave tregtare është përgjegjësi e ASK-së. Në këtë kontekst është propozuar takim i përbashkët në mes të BQK-së, ASK-së dhe MF për të zgjedhur brenda kompetencave dhe hapësirës ligjore këtë çështje.

4. Plani i punës i Këshillit Statistikor për vitin 2013

Këshilli Statistikor si një organ me fuqi rekomanduese, që nga themelimi i tij e deri më tani është përqendruar kryesisht në Programin e Statistikave Zyrtare 2013-2017 i cili tashmë është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Përkundër periudhës relativisht të shkurtër të themelimit, Këshilli Statistikor ka qenë proaktiv në adresimin e çështjeve me rëndësi në funksion të sistemit statistikor të Republikës së Kosovës. Prioritetet e identifikuara të Këshillit Statistikor që njëherësh përbëjnë planin e punës për vitin 2013 kanë të bëjnë me: (i) avancimin e sistemit statistikor të Kosovës, (ii) monitorimin e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare, dhe (iii) harmonizimin e legjislacionit sekondar.

Konform përgjegjësiave bazuar në Ligjin mbi Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës e specifikuar edhe në Rregulloren Procedurale për Funksionin e Këshillit Statistikor, ky i fundit ka ndër përgjegjësitë kryesore krijimin e sistemit statistikor të Republikës së Kosovës. Kjo i referohet krijimit të grupeve punuese për zhvillimin e direktivave statistikore, për bashkimin e fushave statistikore në sistemin statistikor të Kosovës. Kjo pikë është shumë dimensionale dhe

përfshin gjithë fushat e bashkëpunimit statistikor që nga koordinimi lidhur me mbledhjen e të dhënave, përpilimin, publikimin që me fjalë të tjera nënkupton integrimin e sistemit statistikor në mes të të gjitha institucioneve relevante e deri tek zhvillimi i aplikacioneve të ndryshme statistikore që do përkrahte këtë çështje në kontekst teknik. Avancimi i sistemit statistikor të Kosovës i dedikohet rrafshit kombëtar dhe atij ndërkombëtar. Në nivelin kombëtar hapësirë të veçantë do të ketë adresimi i çështjeve që kanë të bëjnë me prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare. Konsistenca në mes të prodhuesve të statistikave zyrtare dhe të institucioneve publike në përgjithësi do të përbëj bërthamën e kësaj pike. Për më shumë, kjo do të ndikoj në alokimin më efikas të resurseve njerëzore duke mos angazhuar institucionet e ndryshme në të njëjtën punë.

Në nivel ndërkombëtar, tendenca kryesore do të jetë mbi avancimin e mëtutjeshëm lidhur me standardet statistikore ndërkombëtare si (i) kalimi nga Sistemi i Përgjithshëm i Shpërndarjes së të Dhënave (anglisht: *General Data Dissemination Standards – GDDS*) në Sistemin Special të Shpërndarjes së të Dhënave (anglisht: *Special Data Dissemination Standards - SDDS*). Sistemi SDDS për dallim nga ai GDDS përmban kërkesa statistikore më të shumta dhe më specifike, dhe (ii) konvergjenca lidhur me standardet statistikore të Bashkësisë Evropiane si një ndër parakushtet lidhur me anëtarësimin e shteteve në Bashkësinë Evropiane.

Monitorimi i zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare është prioriteti i dytë që hyn në kuadër të planit për vitin 2013. Programi, i miratuar nga Qeveria e Kosovës në fillim të këtij viti, paraqet një dokument voluminoz dhe përfshin periudhën 2013-2017. Përcjellja e zbatimit të projekteve të reja statistikore të prodhuesve të statistikave zyrtare e më gjerë përbën esencën e monitorimit të zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare.

Ndër tematikat të rëndësisë së veçantë në Kosovë është edhe ajo e harmonizimit të legjislacionit sekondar në fushën e statistikave. Konform praktikave të vendeve të Bashkësisë Evropiane, specifikimi, krijimi si dhe harmonizimi i legjislacionit sekondar është më se i domosdoshëm. Kjo do të ndihmonte në eliminimin e mospërputhjeve (potenciale) ligjore lidhur me prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës. Për më shumë, kjo do të ndihmonte në informimin më të drejtë të publikut të gjerë lidhur me statistikat zyrtare në Republikën e Kosovës.